



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.59, datë 08/11/2005

**“PËR TRANSFERIM FONDI NË BUXHETIN E QENDRËS KULTURORE
“TIRANA” NGA FONDI I PROJEKTEVE KULTURORE DHE SPORTIVE
PËR VITIN 2005”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” neni 19, pika 9, neni 32, gërma “dh”, ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 “Për buxhetin lokal”, neni 18 dhe neni 21, ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.12, dt.21/03/2005 “Për miratimin e realizimit të buxhetit për vitin 2004 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitit 2005”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.121, dt.25/02/2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr.540, dt.21/12/1992 “Për krijimin e Këshillave të Kulturës dhe shpërblimin e tyre” pika 4, bazuar në Vendimin Nr.25, dt.12/10/2005 të Këshillit Artistiko-Kulturor, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë financimin e disa projekteve kulturore nga Qendra Kulturore Tirana për vitin 2005.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi të miratojë transferimin e fondit në buxhetin e vitit 2005 për Qendrën Kulturore Tirana në shumën 670.000 lekësh.
3. Efektet financiare të përballohen duke pakësuar fondin e Projekteve Kulturore e Sportive nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për vitin 2005, në shumën prej 670.000 lekësh.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Qendra Kulturore Tirana.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI